## DESTINACIONET TURISTIKE Të RAJONIT (Dibër, Klos, Mat) PËR VITIN 2022

| BASHKIA | Nr. | Objekti/pika/vendi/eventi turistik | Vendndodhja: Njësia Administrative, f | Vendndodhja: Dist. nga rruga nacionale | Shënime mbi vlerat turistike të objektit/vendit |
|---|---|---|---|---|---|
| MAT | 1 | Liqeni i Ulzës dhe zona përreth tij. | Ulëz | 50m nga rruga Burrel-Ulëz | Park Natyror Rajonal - Kategoia IV |
| | 2 | Kanioni i Urakës | Rukaj | 5km nga rruga Burrel-Rrëshen | Monument Natyre - Kategoria III |
| | 3 | Burimi i Shutrejës | Rukaj | 4km nga rruga Burrel-Rrëshen | Monument Natyre - Kategoria III |
| | 4 | Lisi i Qershizës | Rukaj | 700 m nga rruga Burrel-Rrëshen | Monument Natyre - Kategoria III |
| | 5 | Shpella e Nezirit, Blazit, Pëllumbave | Rukaj | 5km nga rruga Burrel-Rrëshen | Monument Natyre - Kategoria I |
| | 6 | Guri i Gjatë | Derjan | 1km nga rruga Burrel-Macukull | Objekt me vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore për zonën e Uxallës |
| | 7 | Parku Kombëtar Zall-Gjoçaj | Derjan | 500 m nga rruga Burrel-Burgajet-Gjoçaj-Melth | Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor -Kategoria II |
| | 8 | Kepi i Skënderbeut në Varosh | Macukull | 3 km nga rruga Burrel-Vig | Monument Natyre - Kategoria III |
| | 9 | Kalaja e Stelushit dhe qyteza mesjetare e Varoshit | Macukull | 4 km nga rruga Burrel-Vig | Rrënoja/Arkeologji - Kategoria I |
| | 10 | Puset e Valcës | Macukull | 20km nga rruga Burrel-Macukull | Monument Natyre - Kategoria III |
| | 11 | Guri i Vashës | Macukull | 5 km nga rruga Burrel-Vig | Monument Natyre - Kategoria III |
| | 12 | Banesa e Dyl Kryekurtit | Macukull | 15 km nga rruga Burrel-Macukull | Kullë/Arkitekturë - Kategoria I |
| | 13 | Tisat e Mbasdejës | Lis | 100 m nga rruga Burrel-Vig | Monument Natyre - Kategoria III |
| | 14 | Dera e Qytezës së Komsisë | Komsi | 7 km nga rruga Burrel-Rrëshen | Fragment mur/Arkitekturë - Kategoria I |
| | | | | | |
| DIBER | 1 | Kalaja e Grezhdanit | Maqellarë, Grezhdan | 0 | Kalaja e Grazhdanit ndodhet në fshatin e sotëm Grazhdan dhe zë vend kryesor në rajonin e Drinit të Zi (Shqipëria VL). Vendosur në nyjen lidhëse ndërmjet rrugës Egnatia dhe Lissus-Naissus, me sipërfaqe 34 ha dhe mure rrethuese 3,20 m të gjera, me perimetër 3000 m, përforcuar nga tri porta masive dhe 44 kulla të tipeve të ndryshëm, si katrore, freskore, drejtkëndore dhe në formë U-je, rradhitet në qendrat më të mëdha të shekullit IV në Shqipëri. Pas gërmimeve të kryera në linjat e mureve lindore dhe juglindore ku përfshihen 11 kulla së bashku me portën lindore. Gërmimet e vitit 2012 u përqëndruan përgjatë linjës jugore të fortifikimit në hapsirën ndërmjet kullave dhe portës jugore. Linja e murit rrethues në pjesën jugperëndimore krijon një hark të rregullt, që njihet nga vendasit me toponimin ‘’*stadium*’’. Fortifikimi i saj me dy kulla në formë U-je është një element që haset pothuajse në të gjitha kështjellat fushore ushtarake si në Skampis (Elbasan) në rrugën Egnatia, Ulpianë (Justiniana Secunda ), përgjatë rrugës Lissus –Naissus etj, datuar në shek.IV pas Krishtit. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| DIBER | 2 | Kalaja e Lashkizës | Zall Dardhë, Lashkizë | 5km nga rruga Peshkopi - Zall Dardhe | Daton ne vitin 1565 / SHEK VI pas Kr. Muret rrethuese te kalase se Lashkizes kane perimeter afro 114 m linear, me nje planimetri mjafte te thjeshte e cila eshte drejtekendore. Siperfaqja e pergjithshme e kalase eshte 790 meter. Muret e kalase se Lashkizes jane ndertuar me gure dhe llaç gelqeror. Lartesia e mureve te kalase jane 0.3 meter. Gjeresia e ketyre mureve eshte rreth 0.8 meter. Kalaja 450 vjeçare ka nevojë për kërkime arkeologjike. |
| | 3 | Kalaja e Dodës | Kala e Dodës, Ceren | 0.5km nga rruga Peshkopi-Kukës | Ndodhet ne fshatin Ceren, NjA Kala e Dodes i perket periudhes antike te vone, perfaqesohet nga fragmente muresh, pasi jo e gjithe gjatesia e mureve te kalase se Dodes jane te zbuluara, duke perjashtuar vetem nje pjese te vogel e cila eshte e zbuluar duke treguar edhe egzistencen e vete kalase. Kalaja eshte ne forme kater-kendore dhe me nje hyrje te vetme nga lindja e saj. Muret e kalase se Dodes jane ndertuar me gure dhe gelqere. Lartesia e murit te zbuluar te kalase eshte 1 meter. |
| | 4 | Gradishta e Bellovës | Melan, Bellovë | 4km nga Peshkopia | Ndodhet ne fshatin Bellove, I perket shek VI – IX p.e.s dhe shek V – VI e.s. Gradishta e Belloves ka qene nje vendbanim i hershem ne dy periudha te ndryshme: shek vi – ix p.e.s dhe shek v – vi e.s. Ne territorin e saj jane gjetur disa fragmente muresh. Ka nje pozicion gjeografik qe kontrollon te gjithe pellgun qe lidh qytetin e Peshkopise me zonen ku ishte ngritur qyteterimi ne Bellove. Siperfaqja e qytezes eshte e pjerret e shkallezuar, por ka edhe tarraca te pershtatshme per banim. Muret jane ndertuar me gure dhe llaç gelqeror. Ka nevoje per germime |
| | 5 | Qyteti I Skënderbeut | Selishtë, Qafë Murrë | 0.5km nga rruga Peshkopi-Selishtë | Shpallur si monument kulture nga Rektorati i universitetit Shteteror me 15.01.1963. Kalaja e Skenderbeut ndodhet ne fshatin Qafe Murre te rrethit Diber, ne te majte te perroit te Varoshit, Njesia Administrative Selishte<br>Kjo kala kontrollon rrugen qe lidh pellgun e Peshkopise me Matin. Sipas studiuesve kalaja ka pas qene vendbanim i lashte Ilir. Eshte banuar ne periudhen e hekurit, dhe si i tille ka vazhduar deri ne kohen antike dhe eshte banuar edhe ne mesjeten para turke shek XIII – XV. Qyteti i Skenderbeut eshte ndertuar me gure dhe llac.<br>Ka fragmente te ndryshme muresh por pjesa me e madhe eshte shkrep. |
| | 6 | Kisha e Shën Sotirit | Maqellarë, Kërçish | 4km nga Maqellara | Objekt kulti rreth 700 vjeçare është kishë e vogël njënefshe me përmasa të brendshme 3.4x6.3m. Nga ana strukturore kisha paraqet një zgjidhje të thjeshtë. Çatia e kishës është me dy faqe me konstruksion druri dhe është mbuluar me rrasa guri.<br>Pjesa lindore përmban ambjentin e altarit nga e cila del absida trefaqëshe. Protezisi dhe diakonikoni janë gjithashtu të formuara dhe të pajisur me nike. Altari ndahet nga naosi me një iconostas të drunjtë. Muratura e kishës është ndërtuar me gurë pothuajse të papunuar, lidhur me llaç gëlqere. Interieri i Kishës është i dekoruar me pikturë murale.<br>Koordinatat gjeografike të monumentit janë 41034’55.99’’ N dhe 20031’12.40’’ E |
| | 7 | Xhamia e Allajbegisë | Maqellarë, Allabej | 1km nga Maqellara | Ndodhet ne fshatin Herbel te NJA Maqellare. Kisha Shpërfytyrimit është kishë e vogël e përbërë nga salla e lutjeve dhe nga altari. Ka një planimetri të thjeshtë katër-këndore. Në të hyhet nga një portë në anën veriore, poshtë kryqit të saj. Përreth saj janë varret e vjetra të banorëve të krishterë që kanë pas jetuar në atë zonë. Kisha e Shpërfytyrimit ka ndërtim të thjeshte Pronaus – Naus – Apside. Apsida është 3 faqëshe. Kjo kishë i takon periudhës para pushtimit turk dhe shërben sot si altar. Muri është ndërtuar me gurë gelqeror lidhur me llaç gelqereje dhe tulla. Tullat janë vendosur mes gurëve dhe mes rreshtave. Kisha është mbuluar me çati me dy pjerrësi me tjegulla vendi. Dyshemeja është e përbërë prej pllakave të gurit. |
| | 8 | Banesa e Mudë Sali Kadrisë | Melan, Bellovë | 4km nga Peshkopia | Daton në vitin 1585, SHEK XVI ndodhet ne fshatin me te njejtin emer te NJA Maqellare. Xhamia e Allajbegisë është xhami mesatare e përbërë nga salla e lutjeve, nafili dhe minarja. Salla e lutjeve ka përmasa 6.4m * 6.27m. Në të hyhet nga një portë në anën veriore, nëpërmjet mitepit që është ndërtuar në fillim vitet 90’. Dritaret janë në formë drejtëkëndore me korniza guri. Muratura është realizuar me teknikën e kluasenazhit që haset rrallë në zonën Verilindore. Gure, tulla dhe gelqere është përdorur për ndërtimin e murit. Çatia e xhamisë është në formë kupole dhe e mbuluar me tjegulla ne formë “U”. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| DIBER | 9 | Kulla e Selman Tolles | Lurë,<br>Fushë Lurë | | Kulla e Selman Tolles ndodhet ne qender te fshatit Fushe Lure I perket shek XVIII. Kjo kulle ka vlera te medha arkitekturore. Ndertesa eshte tre kateshe, tipike per zonen. Banesa eshte e ndare ne tre ambiente, ne katin e pare per te qendruar sherbetoret, ne katin e dyte familjaret dhe ne katin e trete dhoma e miqve. Kulla e Selman Tolles eshte e ndertuar me tekniken vendase te kohes me gure dhe llac gelqeror. Ne cepet e mureve si dhe perreth deres dhe dritareve jane vendosur gure ne forma katrore qe i japin nje pamje mjafte te bukur objektit. |
| | 10 | Kulla e Reshit Zunës | Kastriot,<br>Sohodoll | 3km nga rruga Peshkopi-Kukës | Banesa e Rreshit Zunës ose e njohur si Kulla e Zunës e ndertuar në 1827, ka një planimetri të thjeshtë katër-këndëshe me përmasa 7m-7.7m dhe lartësia 11m. Gjërësia e murit të kullës është 1m. Kulla është 4-katëshe dhe ka 7 dritare me përmasa 1m x 0.70m. Porta e kullës ka përmasa 0.96x1.60m. Kulla e Zunës është ndërtuar me gurë dhe gelqere. Katet nga i dyti kanë frengjitë me hekura të cilat janë të shumta. Teknika e ndërtimit është unikale në llojin e vetë. Gjithashtu kulla është rrethuar me avlli. |
| | 11 | Banesa e Dom Nikoll Kaçorit | Lurë,<br>Krej | 0.5km nga rruga Lurë-Kurbnesh | Banesa vazhdon te jete e banushme qe prej 138 viteve nga koha kur ka lindur dom Nikolla. Në dhomën ku është improvizuar një mini-muze, ruhen shumë relikte të priftit, ndonëse më së shumti janë libra dhe revista që kanë shkruar për dom Nikollën. Dom Nikoll Kaçorri per kontributin e dhene eshte nderuar me "Urdhërin e Lirisë së Klasit të I-rë", ndersa ish presidenti z. Bamir Topi e ka dekoruar me datë 17 dhjetor 2007 Dom Nikollë Kaçorrin (Pas vdekjes), me Urdhrin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu". Me profesion: Klerik, Aktivist, Politikan kontribuoi si nënshkrues i Deklaratës së Pavarësisë, Zv/Kryeministër, themelues e alfabetit shqip |
| | 12 | Kulla e Dine Hoxhës | Muhur,<br>Muhur | 1km nga rruga Peshkopi-Zall Dardhë | Kjo kulle eshte tre kateshe dhe eshte ndertuar ne vitin 1929. Secili kat eshte i ndare ne nje ambient te vetem.<br>Ne katin e pare rrinin sherbetoret. Ne katin e dyte jetonte familja e Dine Hoxhes dhe ne katin e trete dhe te kater rrinin mysafiret e shumte. Kjo kulle eshte ndertuar me gure, llac dhe breza druri. Qoshet e mureve jane ndertuar me gure te punuar. Çatia eshte mbuluar me tjegulla vendi. |
| | 13 | Kulla e Zef Doçit | Lurë,<br>Fushë Lurë | | Kulla e Zef Doçit e ndërtuar 100 vjet më parë dhe ndodhet në qendër të fshatit Fushë- Lurë. Është tre katëshe me stehë guri . Ndryshe nga kullat dhe banesat e tjera, kulla e Zef Doçit pamjen ballore e ka nga ana e veriut. Kjo kullë është ndërtuar me teknikën vendase me gurë dhe llaç gëlqeror. Ka elemente tipike të kullës së Veriut, karakteristike për zonën. Çatia e kullës është e mbuluar me furde, diçka e rrallë në vendin tonë. Ndodhet tek Lagjja e Hoxhe, fshati Muhurr. |
| | 14 | Shpella e Gurit të Kuq | Muhur | 1km nga Muhuri | Ndodhet ne afersi te fshatit Muhurr, 500 m mbi nivelin e detit. Perben nje shpelle karstike te formuar ne gelqeroret e triasit te siperm. Eshte e gjate 400 m e gjere deri ne 2-3 m dhe e larte 4 m, shpella ka konkrecione te shumta dhe me bukuri te rralle. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. |
| | 15 | Karsti I Malit të Bardhë | Sllovë,<br>Sllatinë | 6km nga rruga Peshkopi-Kukës | Ndodhet ne afersi te fshatit Sllatine ( NJA Sllove), ne nje territor te perbere nga gjipset e permianit te siperm triasi i poshtem, ne te cilet eshte i zhvilluar fuqimisht procesit i karstit, i cili ka formuar nje peisazh me nje mori formash negative karstike, sidomos hinka te ngushta dhe te thella. Eshte i gjate rreth 1200 m dhe i gjere deri ne 230 m. Ne te njejten kohe perben edhe nje ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike. |
| | 16 | Burimi dhe shpella e Sopanikës | Arras,<br>Çidhën e Poshtme | 3km nga rruga Peshkopi-Zall Dardhë | Ndodhet ne afersi te fshatit Çidhen e Poshtëme, ne lartesine 400 m mbi nivelin e detit. Perben nje burim karstik me prurje 150 1/sek, qe del ne kontaktin litologjik midis gelqeroreve dhe terrigjeneve. Ka uje te paster dhe te ftohte.Krijon nje mjedis shume terheqes. Kane vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, kulturore, didaktike dhe turistike. |
| | 17 | Liqenet e Kacnisë | Selishtë,<br>Kacni | 15km | Ndodhet ne afersi te fshatit Kacni (NJA Selishte), ne shpatin lindor te malit te Balgjajt ne lartesine mbi 1700 m.Jane te vendosura ne disa cirqe te medhenj komplekse akullnajore.Perbejne liqene akullnajore. Jane te gjate mesatarisht 50-100 m dhe te gjere 20-35 m. Kane uje te fohte e te paster si kristali. Gjate dimrit ngrijne ne siperfaqe. Jane te pasur me nje botë te gjallë dhe formojne nje ekosistem interesant te liqeneve alpine.Kane vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Megjithe keto, duhet te permendim se gjate 20 viteve te fundit , ne kuroren e drureve qe ndodhen per rreth liqeneve te Kacnise, ka patur dhe vazhdon te kete demtime te drureve pyjor nga prerjet e paligjshme te cilat |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| DIBER | 18 | Pasqyrat e Gramës | Sllovë, Sllatinë | | Ndodhet ne malin e Grames, ne afersi te fshatit Sllatine, 1900 m mbi nivelin e detit. Perben nje gur te madh me perberje gjipsore te llojit selenit, prej te cilit ka marre edhe emrin “Pasqyrat”. Eshte e gjate deri ne 500 m i gjere deri ne 200 m. Kane vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike. |
| | 19 | Gropa e Panairit | Kala e Dodës, Radomirë | 10km nga rruga Peshkopi-Kukës | Ndodhet afer fshatit Radomire, 2115 m mbi nivelin e detit rreze malit te Korabit. Perben nje cirk te madh kompleks akullnajor te formuar ne rreshpe. Eshte e gjate 800 m e gjere deri ne 230 m. Ka formen e nje amfiteatri gjigand me fund te sheshte dhe shpate te thepisra. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike, turistike dhe kulturore. |
| | 20 | Liqeni I Zi Radomirë | Kala e Dodës, Radomir | 4 km nga rruga Peshkopi-Kukës | Ndodhet ne afersi te fshatit Tejz (Radomire), ne masivin e malit te Korabit, ne lartesine mbi 1460 m i vendosur ne nje cirk te madh kompleks akullnajor. Perben nje liqen akullnajor, me siperfaqe rreth 0.8 ha. Ka uje te paster si kristali dhe te ftohte. Gjate dimrit ngrin ne siperfaqe. Eshte i pasur me nje bote te gjalle dhe formojne nje ekosistem interesant te liqeneve alpine. Kane vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Ka vizitore te shumte gjate veres. |
| | 21 | Ujëvara e Pocestit | Maqellarë, Pocest | 6 km nga rruga Peshkopi-Tiranë | Ujëvara e Pocestës në NJA Maqellarë. Gjendet në malin e Deshatit, 1500 m mbi nivelin e detit. Uji del në lartësinë 13 m përgjatë një të çarë të shkëmbit gëlqeror. Formon një mjedis me bukuri mahnitëse, vlera shkencore hidrologjike, didaktike turistike. Vizitohet sipas rrugës rurale Peshkopi–Maqellarë-monument. |
| | 22 | Bjeshka e Zonjave Zimure | Tomin , Zimur | 12 | Gjendet në Malin e Korabit, 1700 m mbi nivelin e detit. Përbën shpatullim akullnajor në rreshpe, 1000 metra i gjatë, 100- 180 m i gjerë. Në formën e ballkonit natyror me kullota alpine, ka vlera shkencore gjeomorfologjike, ekologjike, didaktike, turistike. Vizitohet sipas rrugës Peshkopi Zimur-rruga këmbësore te monumenti. |
| | 23 | Gryka e Setes(kanioni) | Fushe-Cidhen | 2 km nga Arrasi | Ndodhet ne sektorin e mesem te rrjedhjes se Setes (dege e Drinit te Zi) 700 m mbi nivelin e detit. Perfaqeson nje kanion ne gelqeroret e triasit te siperm–jura e poshteme, te formuar nga veprimtaria erozive e lumit me te njejtin emer, pjesa me e ngushte dhe me e thelle). Eshte i gjate rreth 1.5 km, i thelle rreth 150 m dhe i gjere rreth 4-7 m. Ka shpate te thepisura. Ne te njejten kohe perben edhe nje ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. |
| | 24 | Shpella e Rusit (Gryke Noke) | Fushe Cidhen, Grykë Nokë | 1km (Arras-Lurë) | Ndodhet ne afersi te fshatit Gryke Noke, ne lartesine 710 m mbi nivelin e detit. Perben nje shpelle karstike te formuar ne gelqerore e triasit te siperm-jura e poshteme. Eshte e gjate 10-15 metra, e gjere deri ne 2 m dhe e larte 2 m. Shpella ka konkrecione te shumta. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore |
| | 25 | Shpella e Qytezes | Melan, Bellovë | 4 km nga Peshkopia | Ndodhet ne lindje te qytetit te Peshkopise ne afersi te fshatit Bellove, 1400 m mbi nivelin e detit. Perben nje shpelle karstike te formuar ne gjipset e permianit te siperm-trasi i poshtem. Eshte e gjate mbi 10 metra, e gjere deri ne 2 m dhe e larte 2-3 m. Shpella ka konkrecione te shumta. Ne te ka mbetje te aktivitetit te njeriut lashte. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, arkeologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Ka vizitore te shumte gjate muajve te veres. |
| | 26 | Shpella e Akullit –Bulaç | Bulac/Muhurr | 6km nga Muhurri | Ndodhet ne Bulac, ne afersi te fshatit Muhur, 1000 m mbi nivelin e detit. Perben nje shpelle karstike te formuar ne gelqeroret e triasit te siperm- juria e poshteme. Eshte e gjate 50 metra, e gjere deri ne 3 m dhe e larte 2 m. Shpella ka konkrecione te shumta. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Ngjitja per ne shpelle eshte e nivelit te veshtire |
| | 27 | Burimi i Ujit te Ftohte Vleshe | Sllove, Vleshë | 1km (Peshkopi-Kukës) | Gjendet pranë fshatit Vleshë, 800 m mbi nivelin e detit. Del në kontaktin midis gëlqerorëve dhe rreshpeve. Me ujin e pastër, krijon mjedis tërheqës dhe vlera shkencore hidrologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet sipas rrugës Peshkopi- Vleshë. |
| | 28 | Burimi i Kerçinit | Maqellare, Kërçisht | 6km nga Maqellara | Ndodhet ne afersi te fshatit Kerçisht , 2000 m mbi nivelin e detit. Perben nje gur gelqeror i kretes se siperme, me forme te vecante i formuar ne gelqeroret. Siperfaqja e tij 12.5 ha. Ne te organizohen festa fetare me origjine pagane. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| DIBER | 29 | Kroi i Mbretit-Serakol | Kala e Dodes, Radomirë | 3km (Peshkopi-Kukës) | Ndodhet ne afersi te fshatrave Radomire e Ceren, ne lartesine 1200 m mbi nivelin e detit. Perbejne nje burim karstik, qe dalin ne kontaktin litologjik midis gelqeroreve dhe terrigjeneve. Ka uje te paster dhe te ftohte. Krijon nje mjedis shume terheqes. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, kulturore, didaktike dhe turistike |
| | 30 | Burimi Termomineral i Llixhave te Peshkopise | Peshkopi | 1.5km nga Peshkopia | Gjendet në lindje të qytetit të Peshkopisë, në Luginën e Sherrimit (përroit të Banjave). Lidhet me shkëputjen tektonike. Ujërat me temperaturë rreth 40 C, kripëra dhe gaze të tretura kurojnë reumatizmën, artritet, poliartritet. Pacientët vijnë nga gjithë Shqipëria në mjedise hotelerie me shërbim mjekësor. Kanë rëndësi shkencore (gjeologjike, hidrogjeologjike), ekonomike, didaktike, turistike, etj. Vizitohen sipas rrugës rurale Peshkopi-Llixha |
| | 31 | Liqeni i Luleve Lure | Lure | 17 km nga Lura | Liqeni i Luleve. Me sipërfaqe rreth 45 ha, gjendet në cirk akullnajor në Parkun Kombëtar të Lurës, në Kurorën e Lurës, 1600 m mbi nivelin e detit. Është liqen akullnajor. Dallon për zambakët e bardhë me bukuri të rrallë që çelin në qershor. Ka vlera shkencore (hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike. Vizitohet sipas rrugës Peshkopi–Fushë Lurë. |
| | 32 | Liqeni i Zi Lure | Lure | 15km nga Lura | Ndodhet ne lartesine mbi 1630 m te malit te Kurores se Lures i vendosura ne nje cirk te madh kompleks akullnajor.Perben nje liqen akullnajor me siperfaqe rreth 3 ha. Dallohet per thellesine me te madhe se te liqeneve te tjere akullnajore te Lures. Ka uje te paster si kristali dhe te ftohte.Gjate dimrit ngrin ne siperfaqe. Eshte i pasur me nje bote te gjalle te larmishme dhe formon nje ekosistem interesant te liqeneve alpine. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. |
| | 33 | Liqeni i Madh Lure | Lure | 8km nga Lura | Ndodhet ne parkun Kombetar te Lures, ne lartesine mbi 1600 m te malit te Kurores se Lures , i vendosur ne nje cirk te madh kompleks akullnajor.Perben nje liqen akullnajor, me siperfaqe rreth 12 ha. Ka uje te paster si kristali dhe te ftohte. Gjate dimrit ngrin ne siperfaqe, ndersa gjate veres mbulohet nga zambake te medhenj e te bardhe. Eshte i pasur me nje bote te gjalle te larmishme dhe formon nje ekosistem intersant te liqeneve alpine. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike, estetike, didaktike, ekologjike, dhe kulturore |
| | 34 | Hartinat e Lures | Lure | 2km nga Lura | Ndodhet ne Parkun Kombetar te Lures, ne afersi te fshatit Fushe Lure, 1600 m mbi nivelin e detit.Perben nje grup druresh me trung dhe kurore te vecante (trekendeshi) me lartesi 20-30 m dhe diameter te trungut rreth 40- 50 cm dhe moshe 30 - 70 vjecare. Kane vlera shkencore, biologjike dhe ekologjike, kulturore, didaktike dhe turistike. |
| | 35 | Shllinasi | Kastriot, Vranjt | 3km nga Kastrioti | Ndodhet ne Malin e Bardhe, ne afersi te fshatit Vrenjt 1200 m – 1500 m mbi nivelin e detit. Perben nje masiv shkembor me perberje gjipsi dhe kripe guri. Eshte e gjate deri ne 900 metra, i gjere deri ne 250 dhe e larte deri ne 200 m. Ne te shkojne dhite e egra per te lepire kripen. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike) didaktike, ekologjike dhe kulturore. Ndodhet larg zonave te banuara. |
| | 36 | Guri i Kerçinit | Maqellare, Kërçisht | 9 | Ndodhet ne afersi te fshatit Kercisht, 2000 m mbi nivelin e detit. Perben nje gur gelqeror i kretes se siperme, me forme te vecante i formuar ne gelqeroret. Siperfaqja e tij 12.5 ha. Ne te organizohen festa fetare me origjine pagane. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. |
| | 37 | Karsta e Pocestit | Maqellare, Pocest | 7km nga Maqellara | Ndodhet ne afersi te fshatit Pocest, 1500 m mbi nivelin e detit. Perben nje habitat te formuar ne nje territor me perberje gelqerore dhe me bimesi te vecante dhe te larmishme (shkoze, ah, lajthi, panje, frasher, molle e vodhe te eger, dellinje, trendafil i eger, etj). Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. |
| | 38 | Boroviku i Begjunecit | Melan, Begjunec | 3km nga Peshkopia | Ndodhet ne afersi te fshatrave Begjunec e Rabdisht, 785-1350 m mbi nivelin e detit. Perben nje habitat te formuar ne nje territor me perberje gjipsore dhe me bimesi te vecante dhe te larmishme (pishe e zeze te pa zhvilluar mire per shkak te formacionit gelqeror ku eshte instaluar, ah, lajthi, panje, frasher, dushk, etj), ka edhe kafshe te rralla si kaproll. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. |
| | 39 | Burimet e Belloves | Melan, Bellovë | 3km nga Peshkopia | Burimet e Bellovës. Gjenden në fshatin me të njejtin emër, NJA Melan. Janë burime karstike, që dalin në kontaktin midis gjipseve dhe rreshpeve. Me ujin e pastër krijojnë mjedis tërheqës, që u japin vlera shkencore hidrologjike, didaktike dhe turistike. Vizitohet duke ndjekur rrugën rurale Peshkopi-Bellovë. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| DIBER | 40 | Gryka e Madhe Lure | Lure, Armollë | 2 km nga Lura | Ndodhet ne sektorin e mesem te rrjedhjes se Molle Lures (dege e Drinit te zi), 380 m mbi nivelin e detit. Pefaqeson kanion ne gelqeroret e triasit te siperm-jura e poshtme, te formuar nga veprimtaria erozive e lumit me te njejtin emer. Eshte i gjate rreth 1.3 km i thelle rreth 50 m dhe i gjere rreth 6 m. Ka shpate te thepisura. Ne te njejten kohe perben edhe nje ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike, didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. |
| | 41 | Cirku i Kurores se Lures | Lure | 4km nga Lura | Ndodhet ne malin e Kunores se Lures, 1830 – 2000 m mbi nivelin e detit. Perben nje cirk te madh akullnajor i formuar ne magmatike. Eshte i gjate 900 m, i gjere deri ne 350 m. Ka formen e nje kolltuku gjigand me disa forma me te vogla karstike. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. |
| | 42 | Kodra e Parave Blliçe | Fushe-Cidhen, Blliçe | 1km nga Blliçe | Ndodhet ne afersi te fshatrave Blliçe e Kukaj, 493 m mbi nivelin e detit. Perben nje koder karakteristike ne formen e nje kupole dhe forme te vecante (vezake). Legjenda e thote se ne kete koder te paret kane fshehur thesarin. Ka vlera shkencore, gjeologjike, gjeomorfologjike ,didaktike, ekologjike dhe kulturore. |
| | 43 | Fusha e Pelave Lure | Lure | 0,5km nga Lura | Ndodhet ne Parkun Kombetar te Lures, ne lartesine 1580 m mbi nivelin e detit. Si forme relievi perben nje cirk te ceket akullnajor, qe per nje kohe ka qene e mbuluar nga nje liqen glaciar, i cili me pas u tha. Ne te njejten kohe fusha e Pelave perben edhe nje habitat interesant te llojeve te ndryshme te livadheve alpine. Ka vlera shkencore,gjeologjike, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike, dhe kulturore. |
| | 44 | Rrapi i Kerçishtit | Maqellare, Kërçisht | 2km nga Lura | Ndodhet ne fshatin Kerçisht i Poshtem (NJA Maqellare), ne qender te fshatit 50 m poshte xhamise se fshatit, ne lartesine 700 m mbi nivelin e detit. Mosha e tij eshte rreth 250 vjeçare. Nuk eshte i demtuar. Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike, kulturore e fetare. |
| | 45 | Pisha e Bllices | Fushe-Cidhen, Blliçe | 2km nga Blliçe | Pisha eshte e llojit pishe e zeze. Ndodhet ne fshatin Blliçe, ne lagjen e Blliçes Poshteme ( Ne vakufin e teqes Dede Skepit) ne lartesine 475 m mbi nivelin e detit. Mosha e saj eshte rreth 150 vjeçare. Nuk eshte e demtuar pavaresisht se pothuaj çdo vit preket nga procesionaria e pishes. Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike, kulturore e fetare. |
| | 46 | Lisi i Dobit | Muhurr, Dobe | 0.5km nga FushëMuhurrri | Lisi i Dobit,(Lisi i Bunarit), ndodhet ne afersi te fshatit Fushe-Muhurr (NJA Muhurr). Ka vlera shkencore, gjeomorfologjike, biologjike, didaktike, ekologjike, kulturore e fetare. |
| | 47 | Vakufi i Canges | Muhurr, Fushë Muhur | 2km nga F.Muhurri | Ndodhet ne fshatin Kovashice (Lagjia Çangë). (NJA Maqellare). Eshte dushk me origjine llastarore, cungishte. ( Pjese e pyllit te dushkut me origjine llastarore me moshe rreth 25 – 30 vjeçare,qe mbrohet nga fshati si vakuf ),vend per varreza. |
| | 48 | Lisi i Kabe | Tomin, Kabe | 1.5km nga Tomini | Lisi i Kabe, ndodhet ne afersi te fshatit Pilafe, lagjia Kabe (NJA Tomin).Vendodhja e tij ofron nje pamje te gjere te lugines se Drinit te Zi. Ndodhet 30 min ecje nga qyteti I Peshkopise. |
| | 49 | Vakufi i Sines se Siperme | Arras, Sinë | 4km nga Arrasi | Ndodhet ne afersi te fshatit Sine e Siperme (komuna Arras) .Pylli nuk eshte demtuar dhe ruhet si vakef, ne te cilin ka disa drure dushku me moshe 150 vjeçare. |
| | 50 | Rrapi i Çidhnës | Cidhen e Poshtme/Arras | 1km nga Arrasi | Ndodhet ne fshatin Çidhen e Poshteme (komuna Arras). Ne fakt aty jane tre drure te vjeter te llojit Plepi te Zi, prane nje burimi me uje te paster e te ftohte. Keto drure nga populli thirren me emrin “Rrap” duke u nisur nga madhesia e mosha e tyre. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| DIBER | 51 | Parku Kombetar “Korab-Koritnik” | Shtrihet ne te gjithe pjesen Verilindore te bashkise Diber | 0-15 | Ky park perfshin nje oulevard te gjere ne dy qarqet fqinje te Dibres dhe Kukesit me nje siperfaqe te pergjithshme prej 55550.2 ha, nga te cilat ne Diber perfshin nje siperfaqe prej 20 663.4 ha .<br>Ky masiv mbetet nje nga zonat me vlera te larta te biodivesitetit. Fondi pyjore perbehet kryesisht nga llojet halore si pisha, arrneni, bredhi, kurse nga llojet fletore zoterohen nga ahu i thjeshte si dhe i perzier, dushqet, lajthia, e me rralle panja, frasheri,meshtekna etj.<br>Perveç bimeve te larta ne forme druri , bimesia barishtore e kullotave eshte nga me te pasurat jo vetem ne vendin tone per edhe ne Ballkan e me gjere<br>Vlerat e biodiversitetit kesaj zone ia rrit edhe prania e gjitareve te medhenje te mbrojtur si: ariu ,ujku, dhia e eger, e kaprollit dhe me rralle e riqebullit,<br>Ky park perfshin 17 monumente natyre.<br>Ky park perfshin nje oulevard te gjere ne dy qarqet fqinje te Dibres dhe Kukesit me nje siperfaqe te pergjithshme prej 55550.2 ha, nga te cilat ne Diber perfshin nje siperfaqe prej 20 663.4 ha .<br>Ky masiv mbetet nje nga zonat me vlera te larta te biodivesitetit. Fondi pyjore perbehet kryesisht nga llojet halore si pisha, arrneni, bredhi, kurse nga llojet fletore zoterohen nga ahu i thjeshte si dhe i perzier, dushqet, lajthia, e me rralle panja, frasheri,meshtekna etj.<br>Perveç bimeve te larta ne forme druri , bimesia barishtore e kullotave eshte nga me te pasurat jo vetem ne vendin tone per edhe ne Ballkan e me gjere<br>Vlerat e biodiversitetit kesaj zone ia rrit edhe prania e gjitareve te medhenje te mbrojtur si: ariu ,ujku, dhia e eger, e kaprollit dhe me rralle e riqebullit,<br>Ky park perfshin 17 monumente natyre. |
| | 52 | Parku kombetar Lure | Lurë | 0-15 | Shtrihet në malësinë e Lurës dhe zë një sipërfaqe prej rreth 1300 ha. Ka territor shumë te thyer nga një radhë përrenjsh malorë ku më të njohurit janë Seta, Uraka, Malla e Lurës. Parku shtrihet përreth malit Kurora e Lurës (2121 m). Pylli i Lurës përbëhet nga drurë gjethore e halore.<br>Përhapjen më të madhe e ka ahu, që formon pyje të dendura me një shtrirje deri në lartësinë 1600-1700 m. Mbi ahun rritet rrobulli, pisha e zezë, pisha e bardhë. Mbi lartësinë 1700 m rritet arneni i zi dhe arneni i bardhë.Bukuri e kësaj zone janë dhe liqenet e saj. Gjithsej në këtë zone ndodhen 12 Liqene që në gjithë Shqipërinë njihen si, Liqenet e Lures.<br>Mbi liqene rritet një bimësi higrofile, siç është zambaku i ujit me lulet e bardha të mëdha, të cilat në verë pushtojnë gjithë sipërfaqen e tyre duke u dhënë një bukuri të rrallë. Vlera botanike dhe ekologjike e parkut pyjor te Lurës lidhet si me pasurinë, shumëllojshmërinë dhe vjetërsinë e drurëve, shumë prej të cilave kanë moshë shekullore, ashtu dhe me liqenet akullnajore, që janë nga më të bukurat e Shqiperise me oulevard e thyer e të larmishëm. |
| | 53 | Zona e mbrojtur Luzni-Bulac | Luzni-Muhur | 8 | Sipërfaqja totale përveç tokës së bukës e ngastrave të kësaj zone është 5696 hektarë nga të cilat 1526 hektarë i kanë kaluar rrethit të Bulqizës në korrik të vitit 1992 dhe 4170 hektarë i kanë mbetur rrethit Dibër. Zona ka motive natyrore tërheqëse për turistë si kullota e pyje të rinj, si dhe një rrjet hidrografik të dendur. Ka pyje ahu të përzier me dushk, shkurre si dhe kafshe te egra si: ujku, ariu, dhelpra, deri egër. |
| | 54 | Xhamia e madhe e Peshkopise | Peshkopi | 0 | Ky objek u ndërtua ne vitin 2009, ndodhet ne qendër të qytetit, ka dy ouleva. Në pjesën e brendshme perfshihen zyrat e myftynisë e administrimit, dhoma e imamit, salla e kompjuterave etj. |
| | 55 | Shtatorja e Skenderbeut | Peshkopi | 0.5 | Gjendet përgjatë shëtitores “Elez Isufi”. Inagurimi i monumentit është bërë me 9 Qershor 2009. Realizuar nga Zaim Korsi. I kushtohet Gjergj Kastriotit, Skenderbeu, Heroi ynë kombëtar lindi 1405 dhe vdiq në 1468. Në 1440 u emërua sanxhakbej në Dibër, kjo e fundit një ndër tre sanxhaqet e Shqipërisë së asaj periudhe. Ne qershor te 1444 udhëhoqi betejen e Torvjollit te Dibrës së Poshtme.Përgjatë kësaj periudhe deri në gusht të 1466 ai udhëhoqi edhe 18 beteja te tjera të zhvilluara në Dibër. |
| | 56 | Muzeu i Peshkopise | Peshkopi | 0.5 | Ndodhet në Bulevardin “Elez Isufi” në qendër të qytetit. Ndërtesë tradicionale me arkitekturë tipike, ku janë ekspozuar rreth 2.000 objekte të shfaqura për vizitorët. Ndahet në tre pavione: I oulevard, arkeologjisë, i etnografisë, qe pasqyrojnë gjithë historinë dhe kulturën oulevar e shpirtërore të Dibrës nga neoliti i hershem, deri në ditët tona. Sendet përfshijnë një larmi kostumesh popullore, qilima e tapete, armë të ndryshme që nga periudha ilire, monedha etj. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| DIBER | 57 | Qyteti i Peshkopisë | Peshkopi | 0 | Qyteti i Peshkopisë si qender urbane e bashkise Diber. Eshtë qytet piktoresk, i veshur me drurë të kultivuar dekorativ si: bliri, pisha e zezë, bredhi, mështekna, gështenja e egër, panjë,, etj<br>Blirët në të dy anët e shëtitores "Elez Isufi", i kanë dhënë qytetit të Peshkopisë emrin "Qyteti i Blirëve". Ky boulevard përfaqëson edhe qendrën e qytetit, në ditë të veçanta organizohen aktivitete të rëndësishme si: "Oda Dibrane", panaire etj. Përgjatë këtij bulevardi ndodhen disa prej objekteve kryesore social-kulturore si Bashkia, Institucioni i Prefektit, Muzeu, Pallati i Kulturës, Monumenti i Skënderbeut, Xhamia, etj |
| | 58 | Xhamia e Vjetër Peshkopi | Peshkopi | 0 | Xhamia e Vjetër është mbi 100 vjeçare e tipit kadiri ndodhet në lagjen e Vjetër të qytetit pranë përroit të Llixhave. Në ambjentet e saj është hapur shkolla e parë shqipe në Peshkopi nga Haki Sharofi me 14 prill 1914. Sheh Besimi është një ndër klerikët me dhe një ndër 7 teqet e Dibrës, teqja ka qenë institucion kulti dhe bese.kontribute në çështjen kombëtare. Më 1967 prishet minareja nga regjimi komunist dhe shndrrohet në Shtëpi Pionieri. Më 1990 rikthehet si objekt kulti. Në krah ndodhet Teqja, që është e vetmja në qytet |
| | 59 | Drini i Zi | Pershkon te gjithe territorin e Bashkise Diber | 0-9 | Drini i Zi buron nga burimi i Shën Naumit dhe rrjedha e tij kalon përmes Liqenit të Ohrit<br>në formën e gjarprit nga ka marrë emrin Drini i Zi deri në qytetin e Strugës të cilin lumi e ndanë në dy pjesë.<br>Urat e shumta që lidhin dy brigjet e Drinit të Zi i japin Strugës epitetin "Qyteti i Urave".<br>Lumi rrjedh në veri në drejtim të qytetit të Dibrës se Madhe në një zonë malore.<br>Shënon një pjesë të kufirit Republika e Maqedonisë – Shqipëri, për të kaluar pastaj në territorin e Republikes se Shqipërisë në territorin e Bashkisë Dibër duke u cilësuar si aorta e trojeve shqiptare. Gjatë rrjedhës së tij shoqërohet me bukuri natyrore që janë burim eksplorimi të kanioneve të Gradecit duke qenë kufi i NJ.A. Maqellarë, Melan, Luzni, Muhurr, Arras, Tomin, Kastriot, Zall-Dardhë, Sllovë. Pranë qytetit të Kukësit Drini i Zi bashkohet me Drinin e Bardhë duke formuar lumin e bashkuar Drini që ka derdhje në Detin Adriatik.<br>Gjatësia e përgjithshme e lumit është 149 km.<br>I pershtatshem per rafting, peshkim dhe plazh gjate muajve te veres. Cdo fillim sezoni veror organizohet "Festa e Drinit" si hapje e sezonit turistik. |
| | 60 | Rabdishti-Fshat turistik<br>(I perfshire ne programin e 100 fshatrave turistik si dhe pjesë e projektit të USAID : "Dibra turizëm dhe traditë") | Melan, Rabdisht | 6km nga Peshkopia | Rabdishti shtrihet ne dy monumente te medha natyre ku gjenden: burime te larmishme natyrore;male, bjeshke, burime ujore ku njeri nga ata eshte i perdorshem per vetite kurative, kanione, shpella, shkalle te formuara nga ndikimet shumevjecare te fenomeneve natyrore, perrenj etj Fshati ka bimesi te pasur me peme frutore, pishe e zeze, ah, lajthi, panje, frasher, dushk, akacie, dushk, etj. Nder kafshet qe mund te hasen jane dhelpra, ariu, lepuri, ujku, deri i eger dhe kaprolli.<br>Fshati ka nje histori te lashte dhe kulture te pasur. Ne afersi gjenden rrenoja vendbanimeve hershme, komleksi balnear i Peshkopise, mulliri i vjeter (monument kulture), traditat kulturore jane te larmishme sidomos gjate ceremonive te ndryshme fetare apo ne gezime e festa. Ne pjesen e kufirit me Maqedonine jane interesante percaktimet kufitare pergjate te cilit kalon shtegu turistik. Fshati eshte pjese e nje prej shtigjeve hiking me te gjate e te rendesishem pergjate vargmalit Deshat_Korab, i cili fillon nga Maqellara e ne dalje te Kalase se Dodes. Nje shteg tjeter turistik qe lidhet me shtegun kryesor vjen nga qyteti i Peshkopise dhe pershkon fshatin. Shtegu i sapo permendur eshte i frekuentuar nga motorcikliste, e rally me makina. Gjate dimrit fshati qendron i mbuluar me debore per jave me rradhe gje e cila ben te mundur perdorimin e shpateve per skijim. Ne kete fshat ka dy bujtina dhe iniciativa per te pershtatur te tjera. 15 min larg fshatit ndodhet nje camping. Fshati ka shtepi te ndertuara me gure dhe te mbuluara me rasa, rruge te shtruara me kalldrem, te cilat jane te mirembajtura.<br>Rabdishti është pjesë e projektit të USAID : "Dibra turizëm dhe traditë" dhe " 100 fshatra turistikë" |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| DIBER | 61 | Kërçisht i Sipërm –<br>Fshat turistik<br>(si pjesë e projektit të ALCDF : "Dibra turizëm dhe traditë" | Maqellare, Kërçisht | 4 | Shtrihet rrëzë Parkut Kombëtar Korab- Koritnik nën hijen e Gurit të Kërçinit dhe freskon fytyrën me ujërat e Burimit të Kërçinit që janë shpallur monumente natyre.<br>Fshat i hershëm i zonës së Maqellarës, që e dëshmojnë pjesë të Kalasë së Kërçishtit , ku fiset Xhidra, Saraçi, Bogdani dhe Rada kanë jetuar në bashkëjetesë fetare dhe ekzitojnë edhe sot, kultet e besimit 5 kisha, 2 prej të cilave janë monumente kulture (Kisha Shën Sotiri dhe Shën Dhimitri) dhe xhamia si dhe defterët turk ku figuron regjistrimi i popullsisë prej 40 banorësh.<br>Njerëzit janë mikpritës, punëtorë, që e dëshmojnë fermat dhe pemëtoret.<br>Ndodhet dhe një minierë e squfurit, por nuk është funksionale.<br>Shtegu Kërcisht- Guri i Kërçinit është pjesë e tureve turistike. |
| | 62 | Tejse- Fshat turistik<br>(I perfshire ne programin e 100 fshatrave turistik) | Kala e Dodes, Tejs | 4 | Eshte pjese e Njësisë Administrative Kala e Dodës dhe shtrihet rrëzë malit më të lartë të vendit, Korabit, në një lartësi prej rreth 1500 m mbi nivelin e detit. Fshati eshte pjese e nje prej shtigjeve hiking me te gjate e te rendesishem pergjate vargmalit Deshat_Korab, i cili fillon nga Maqellara e ne dalje te Kalase se Dodes. Nje shteg tjeter turistik qe lidhet me shtegun kryesor vjen nga qyteti i Peshkopise dhe pershkon fshatin. Shtegu i sapo permendur eshte i frekuentuar nga motorcikliste, e rally me makina. Gjate dimrit fshati qendron i mbuluar me debore per jave me rradhe gje e cila ben te mundur perdorimin e shpateve per skijim. Ne kete fshat ka bujtina dhe restorant dhe iniciativa per te pershtatur shtëpi pritëse. 2 orë ecje nga fshati ndodhet maja e Korabit , më e larta në Ballkan.Fshati ka shtepi te ndertuara me gure dhe te mbuluara me rasa. Lidhet me rrugën kombëtare Peshkopi Tiranë dhe me Bjeshkët e Tetovës dhe Prizrenit në zonën ku ndajmë korridore të përbashkëta. Është një vend në lartësitë e Korabit me vlera të mëdha natyrore dhe klimaterike e lakmuar nga vizitorët dhe turistët e huaj në të katër stinët. Ka bimë mjeksore si aguliëja, qershia e egër, sherebela, mëllaga e zezë, njihet për bukuri natyrore dhe shume kafshe te egra ne brendesi te pyjeve perreth. |
| | 63 | Shtegu me Ngjyra-Hight Scardus Trail (krijuar vitet e fundit-2020 nga GIZ po punohet ne vazhdim edhe nga ALCDF) | Shtrihet ne vargmalin Korab-Koritnik ne te gjithe pjesen Verilindore te bashkise Diber | 0-15 | Ky destinacion shqiptar ofron një nga eksperiencat me unike në bjeshkët e Shqipërisë. Ai është një shteg i ri për të eksploruar të apasionuarit pas hiking dhe natyrës. Afër këtij shtegu ndodhet edhe trekëndëshi ndërkufitar Kosovë-Shqipëri-Maqedoni e Veriut.<br>Ekzistojnë disa shtigje lidhëse dhe pika dalëse që çojnë në zona të banuara, që shoqërohen me nivele të ndryshme vështirësie për ecje. Seksioni më i madh i shtegut, rreth 150 km, është në territorin shqiptar ku kalon nëpër Parkun e Natyrës Korab-Koritnik të njohur si një luginë alpine dhe habitat i shumë kafshëve të egra. Pamja që e rrethon është vërtetë magjike dhe përshkohet per rreth 7 orë ecje.<br>Ne territorin e Bashkise Diber shtegu fillon ne Maqellare me pas ngjitesh ne Kercisht te Eperm- Popinare- Erebare(Mali Velivarit)-Hinoske- Rabdisht-Zagrad-Cerjan-Grame-Radomire. Duke kaluar neper shume monumente natyre dhe tre fshatra turistik. Pergjate shtegut ka bujtina, stane dhe po punohet per te shtuar dhe permiresuar sherbimet. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| DIBER | 64 | Fushe-Lure | Fushe-Lure/Lure | 0 | Lura qëndron në krye të kryeveprave natyrore si zonë turistike në veri të vendit.<br>E vleresuar nga shume njerëz të shquar, diplomat, poet të huaj dhe vendas, madje poeti i madh, At Gjergj Fishta shprehet se "Kush nuk njeh Lurën nuk një Shqipërin".!!! Ndërsa, udhëtari i famshëm britanik Edith Durham është shprehur se: "Kur erdha në Qafë Lurë, pashë të tillë një fushë e bukur, që kurrë nuk kisha parë në asnjë vend të Ballkanit".<br>Lura mbetet një hyjneshë e natyrës dhe turizmit malor. Lura është një nga destinacionet turistike në Dibër me kullat dhe oborret e rrethuara me furde prej druri qe janë tradita alpine, e bëjnë shumë tërheqëse këtë zone.<br>Kullat janë unike për sa i përket ndërtimi, me frëngji në katet e dyta dhe pika vrojtimi si kështjella në miniature.<br>Parku Kombëtar i Lurës është në verilindje të Shqipërisë, që përfshin një sipërfaqe prej 12.8 km2, duke përfshirë edhe pjesën lindore të Kurora e Lurës.Parku si zonë e rëndësishme e Zogjve dhe Bimëve, sepse ajo mbështet lloje të konsiderueshme të zogjve dhe bimëve.<br>Zona rreth Lurës përmban shtëpi tradicionale kulla, xhamitë Otomane dhe një Kishë Katolike, rinovuar kohët e fundit. Ndodhet gjithashtu shtëpia e nënshkruesit të pavarësisë shqiptare Dom Nikollë Kaçorri. Liqenet e Lurës në parkun të Lurës ka një sipërfaqe prej 1.280 hektarë dhe ndodhet ne pjesën lindore te malit masiv te quajtur "Kurora e Lurës". Me 14 liqenet e tij akullnajore krijon një ambient piktoresk dhe tërheqës në një lartësi nga 1.350-1.720 m, por që njihet me shtatë Liqenet e Lurës. Në pjesën veriore, përshkruhet rruga që vjen nga Peshkopia, Dibër ku Lura është pjesë e saj.<br>Të tre shtigjet për në Lurë kanë një pamje të pa hasur në asnjë vend tjetër deri sa të mbërrish te hyjnesha e vërtetë e natyrës dhe e turizmit, Lura. Aktualisht Parku Kombëtar i Lurës është zgjeruar edhe me liqenin e Zall-Gjoçaj, duke krijuar Parkun Kombëtar "Lurë-Mali i Dejës". Parku ka një sipërfaqe prej 20 mijë e 242 hektarë.<br>Në veri-pretendim qarkullon një rrugë që vjen mes malit, që fillon nga kepi i Skënderbeut në Mat, shtrihet për gjatë Mas Dejës e që vazhdon në Fushë-Pela, ku qaset me malin e Runjës e për karshi se mburojë ka malin e Dejës, një nga malet më të larta në malet e mesme. |
| KLOS | **1** | Ura e Vashës | Fshati Fshat | 3,5 km | Monument kulture |
| | **2** | Kaja e Xibrit | Xibër | 1,4 km | Monument kulture |
| | **3** | Ura e Halilit | Dars, Klos | 0,8 km | Monument kulture |
| | **4** | Ura e Vogël Gurrat e Kodrës | Guri I Bardhë | 8,5 km | Monument kulture |
| | **5** | Ura e Gurit të Hoxhës | Guri I Bardhë | 0,4 km | Monument kulture |
| | **6** | Kalaja e Skenderbeut | Guri I Bardhë | 9 km | Monument kulture |
| | **7** | Kalldrëmi Gura e Kodrës | Guri I Bardhë | 8,6 km | Monument kulture |
| | **8** | Rrenojat e Kishës | Suç | 0,1 km | Monument kulture |
| | **9** | Banesa e Rexhep Karajt | Dars, Klos | 1,7 km | Monument kulture |
| | **10** | Banesa e Asllan Hutës | Plani I Bardhë | 1,8 km | Monument kulture |
| | **11** | Banesa e Hysni Dedollit | Bejnë, Klos | 3,6 km | Monument kulture |
| | **12** | Banesa e Bajram Allushit | Klos Katund | 0,5 km | Monument kulture |
| | **13** | Banesa e Abdi Domit | Guri I Bardhë | 8 km | Monument kulture |
| | **14** | Banesa e Shaqir Dezhgiut | Guri I Bardhë | 8,2 km | Monument kulture |
| | **15** | Kulla e Elmaz Korbit | Guri I Bardhë | 8,5 km | Monument kulture |
| | **16** | Kulla e Sali Likursit | Gurrë e Madhe | 5,6 km | Monument kulture |
| | **17** | Kulla e Abdulla Zylfit | Kurdari, Suç | 15,5 km | Monument kulture |
| | **18** | Kulla e Mehmet Satës | Kurdari, Suç | 0,7 km | Monument kulture |
| | **19** | Kulla e Dullë Çelës | Patin, Klos | 8,2 km | Monument kulture |
| | **20** | Kulla e Allaman Canit | Patin, Klos | 8,4 km | Monument kulture |
| | **21** | Gurra e Kaçulit | Bel, Klos | 3,8 km | Pasuri natyrore |
| | **22** | Liqenet e Balgjajt | Kurdari, Suç | 15,5 km | Pasuri natyrore |
| | **23** | Mali I Sugzës | Gurrë e Vogël | 12,5 km | Pasuri natyrore |
| | **24** | Liqenet e Allamanit | Kurdari, Suç | 16 km | Pasuri natyrore |
| | **25** | Liqenet e Koçit | Ripë, Gurrë | 5,7 km | Pasuri natyrore |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |